REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E APELIT TIRANË

Numri i Çështjes	90006-04466-30-2016	**Data e Regjistrimit**	12/19/2016
Numri i Vendimit	30-2017-1875	**Data e Vendimit**	5/8/2017

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS

GJYKATA E APELIT TIRANË E PERBERE NGA:

KRYESUES: Edlira Petri

ANËTAR Ilir Toska
Metush SARAÇI

SEKRETARE Esmeralda Likaj

Objekti: 1. Njohje dhe dhenie fuqi ne Republiken e Shqiperise Vendimit te Arbitrazhit mbi ceshtjen Nr. V2015/052 date 06.07.2016, te Institutit te Arbitrazhit te Dhomes se Tregtise se Stokholmit, Suedi; dhe
2. Leshimi i Urdherit te Ekzekutimit per zbatimin jo vullnetar te Vendimit te Arbitrazhit Nr. V2015/052 date 06.07.2016, te Institutit te Arbitrazhit te Dhomes se Tregtise se Stokholmit, Suedi.

Baza Ligjore : Neni 393, 395, 396, 397, 398 dhe 399 si dhe nenet 510/c, 511/b, 310/1 dhe 466/1 te Kodit te Procedures Civile te Republikes se Shqiperise (ne vijim K.Pr.C).
Ligji Nr. 8688, date 09.11.2000 "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne "Konventen per Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve te Huaja te Arbitrazhit" (ne vijim Konventa);
Neni 122 i Kushtetutes se Republikes se Shqiperise;
Vendimi Unifikues i Gjykates se Larte Nr. 6, date 01.06.2011

Përmbledhja e vendimit:

GJYKATA E APELIT TIRANE<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

pasi dëgjoi përfaqësuesit e kërkuesit Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive 1. Shoqëria Consorzio per il Sistema Informativo CSI-Piemonte dhe 2. Shoqëria “FBS” shpk, të cilët kërkuan pranimin e kërkesës, njohjen e vendimit të arbitrazhit të shtetit të huaj dhe lëshimin e urdhrit të ekzekutimit; përfaqësuesit e personit të tretë Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Avokaturës së Shtetit, që kërkuan rrëzimin e kërkesës;
shqyrtoi aktet dhe bisedoi çështjen në tërësi

V E R E N<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

Kërkuesi, Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive, Shoqëria Consorzio per il Sistema Informativo CSI-Piemonte dhe Shoqëria “FBS” shpk (referuar në vijim si Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive), ka depozituar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë kërkesën për njohjen dhe ekzekutimin e Vendimit të Arbitrazhit mbi çështjen Nr. V2015/052, datë 06.07.2016, të Institutit të Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit, Suedi.

Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezultojnë faktet e mëposhtme :

Në datë 13.03.2013, në përfundim të procedurës së prokurimit për "Furnizimin me pajisje IT, instalim dhe integrim të sistemit të pasurive të paluajtshme", është lidhur mes blerësit (entit prokurues) Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive, marrëveshja kontraktore nr. 1079/2 prot., e cila rregullohej nga Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, si dhe ato të Veçanta, të vendosura sipas dakordësisë së palëve.

Në kushtet kontraktore, palët rezulton të kenë rënë dakord edhe për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që mund të lindnin mes tyre, duke përjashtuar juridiksionin gjyqësor. Palët kanë përcaktuar në kushtet e përgjithshme të kontratës zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nëpërmjet arbitrimit në dy shkallë.

Në nenin 6.1 titulluar "Gjykimi", përcaktohet se :

"6.1 Nëse midis Blerësit dhe Furnizuesit lind ndonjë mosmarrëveshje e çfarëdolloji në lidhje me Kontratën, duke përfshirë, pa cenuar sa më lart, çdo çështje lidhur me ekzistencën, vlefshmërinë ose zgjidhjen, ose operimin e Sistemit (qoftë gjatë ecurisë së zbatimit ose pas Pranimit Operacional dhe qoftë përpara ose pas zgjidhjes, braktisjes ose shkeljes së Kontratës) palët do të përpiqen ta zgjidhin mosmarrëveshjen përmes konsultimeve të ndërsjella, brenda katërmbëdhjetë (14) ditësh pasi secila nga palët t'i japë njoftim me shkrim palës tjetër për mosmarrëveshjen, më pas, nëse Marrëveshja Kontraktuale në Shtojcën 2 përfshin dhe emëron një Gjykues, mosmarrëveshja, brenda katërmbëdhjetë (14) ditësh të tjera, do t'i paraqitet me shkrim nga secila nga palë Gjykuesit të specifikuar në Marrëveshjen Kontraktuale, duke vënë në dijeni palën tjetër. Nëse në Marrëveshjen Kontraktuale nuk cilësohet asnjë Gjykues, periudha e konsultimeve të ndërsjella e cilësuar më sipër do të zgjasë njëzet e tetë (28) ditë (në vend të katërmbëdhjetë), me mbarimin e së cilës, secila nga palët mund të vijojë me njoftimin e arbitrazhit, sipas nenit 6.2.1 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës.

6.1.2 Gjykuesi do të japë vendimin e tij ose të saj me shkrim për të dyja palët, brenda njëzet e tetë (28) ditëve pasi mosmarrëveshja t'i jetë paraqitur Gjykuesit. ...

Në përfundim të kësaj faze dhe pas dhënies së vendimit nga Gjykuesi, palët kanë parashikuar edhe mundësinë për t'ia referuar mosmarrëveshjen Arbitrazhit. Kështu, në nenin 6.2 titulluar "Arbitrazhi" përcaktohet se :

"6.2.1 Nëse :

a) Blerësi ose Furnizuesi nuk është i kënaqur me vendimin e Gjykuesit dhe ndërmerr veprime përpara se vendimi të marrë formë të prerë, sipas nenit 6.1.2 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, ose

b) Gjykuesi nuk merr një vendim brenda periudhës së caktuar, duke filluar nga data e paraqitjes së mosmarrëveshjes sipas Nenit 6.1.2 të Kushteve të Përgjithshme dhe Blerësit ose Furnizuesit ndërmerr veprime brenda periudhës katërmbëdhjetë (14) ditore vijuese,

c) Nëse Marrëveshja Kontraktuale nuk parashikon emërimin e një Gjykuesi, konsultimet e ndërsjella sipas nenit 6.1.1 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, nuk rezultojnë në gjetjen e një zgjidhjeje për mosmarrëveshjen dhe Blerësi ose Furnizuesi veprojnë brenda periudhës katërmbëdhjetë (14) ditore vijuese,

Atëherë Blerësi ose Furnizuesi mund t'i japin njoftim palës tjetër, duke vënë në dijeni Gjykuesin, në rast se është i përfshirë edhe një Gjykues, rreth qëllimit për hapjen e procedurave të arbitrazhit, sikurse parashikohet më poshtë, lidhur me çështjen e arbitrazhit dhe arbitrazhi nuk mund të hapet në lidhje me atë çështje nëse nuk jepet një njoftim i tillë.

6.2.2 Çdo mosmarrëveshje për të cilën është dhënë njoftimi për shprehjen e qëllimit për hapjen e procedurave të arbitrazhit, në përputhje me nenin 6.2.1 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, do të zgjidhet përfundimisht nga Trupa Gjykuese e Arbitrazhit. Arbitrazhi mund të fillojë përpara ose pas instalimit të Sistemit të Informacionit.

6.2.3 Procedura e Arbitrazhit do të zhvillohet në përputhje me rregullat e procedurës të specifikuara në KVK. ..."

Në vijim, lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve (KPK Klauzola 6), në kontratë përcaktohet sa vijon

KPK 6.1.4 : "*Autoriteti emërues i Gjykuesit është : Instituti i Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stkoholmit*"

KPK 6.2.3 : *"Procedura e arbitrazhit do të zhvillohet në përputhje me rregullat e arbitrazhit të Institutit të Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit.*

Nëse Furnizuesi është shtetas në shtetin e Blerësit, Kontrata duhet të përmbajë këtë dispozitë: Çdo mosmarrëveshje mes Blerësit dhe Furnizuesit që lind në lidhje me këtë Kontratë do t'i paraqitet për zgjidhje arbitrazhit në përputhje me ligjet e shtetit të Blerësit."

Sipas Kushteve të Veçanta të Kontratës të nënshkruara nga palët, rezulton që ato të kenë rënë dakord për emrin e Gjykuesit.

Rezulton se mes palëve ka lindur mosmarrëveshje për shkak të zgjidhjes së kontratës nga ana e Blerësit, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Kjo e fundit, me pretendimin se Furnizuesi nuk i përmbushi detyrimet kontraktore, në datë 17 qershor 2014, ka zgjidhur në mënyrë të njëanshme kontratën. Për këtë shkak Furnizuesi, Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive, duke pretenduar se zgjidhja e kontratës ishte e pabazuar në kushtet e saj, ka nisur procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, të cilat janë finalizuar me vendimin e dhënë nga Instituti i Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit, i datës 06.07.2016 për çështjen nr. V 2015/052 (më herët mosmarrëveshja i ishte referuar Gjykuesit). Vendimi i arbitrazhit rezulton të jetë i formës së prerë dhe i paankimueshëm, përveç çështjes së shpërblimit të arbitrave (edhe kjo pjesë e vendimit nuk rezulton të jetë ankimuar).

Instituti i Arbitrazhit i Dhomës së Tregtisë së Stokholmit, me vendimin e dhënë prej tij, në pjesën urdhëruese, ka konkluduar si vijon:

"[...]

a) Çmon se Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, nuk ka pasur arsye për të zgjidhur Kontratën dhe duke vepruar kështu ka shkelur Kontratën duke e zgjidhur atë në 17 qershor 2014.

b) Urdhëron Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, t'i paguajë J/V Consorzio per il Sistema Informativo CSI-Piemonte dhe FBS SHPK një shumë prej 716 535 euro me TVSH për pjesën e papaguar të çmimit të Kontratës, bashkë me kamatëvonesën në normën vjetore prej tre (3) për qind (a) mbi 339 104 euro me TVSH, nga data 27 korrik 2014 dhe mbi 83 523 euro me

TVSH nga data 1 gusht 2014 deri në datën e Vendimit të Arbitrazhit; (b) mbi 293 908 euro me TVSH, nga data 1 nëntor 2014 deri në datën e vendimit të Arbitrazhit dhe (c) mbi vlerën e përgjithshme prej 716 535 euro nga data e Vendimit të Arbitrazhit deri në pagesën e plotë.

c) Urdhëron Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, t'i paguajë J/V Consorzio per il Sistema Informativo CSI-Piemonte dhe FBS SHPK dëmshpërblim për kostot në shumën 20 950 euro bashkë me kamatëvonesën në normën vjetore prej tre (3) për qind nga data e Vendimit të Arbitrazhit deri në pagesën e plotë.

d) Urdhëron Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, t'i paguajë J/V Consorzio per il Sistema Informativo CSI-Piemonte dhe FBS SHPK kamatëvonesë mbi shumën 56 800 Euro në normën vjetore prej tre (3) për qind nga data 3 shtator 2015 deri në datën e Vendimit të Arbitrazhit.

e) Mohon pretendimet për fitim të munguar në shumën 246 322 euro, shpenzimet për përzgjedhjen e ekipit ligjor në shumën 5456 euro dhe për degën në Shqipëri në shumën 18 145 euro J/V Consorzio per il Sistema Informativo CSI-Piemonte dhe FBS SHPK.

f) Urdhëron Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, t'i paguajë J/V Consorzio per il Sistema Informativo CSI-Piemonte dhe FBS SHPK shumën prej 133 012 euro për shpenzimet e kryera, përfshirë tarifat ligjore bashkë me kamatëvonesën në normën vjetore prej tre (3) për qind nga data e Vendimit të Arbitrazhit deri në pagesën e plotë.

g) Çmon se Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë duhet të përballojë shpenzimet e veta ligjore dhe shpenzimet e tjera.

h) Çmon se palët janë bashkërisht dhe veçmas përgjegjëse për të paguar shpenzimet e arbitrazhit. Shpenzimet e Arbitrazhit janë caktuar dhe vendosur nga Instituti i Arbitrazhit i Stokholmit si më poshtë : Lars Gothlin, Tarifa : 30 007 euro; Dieta 1000 euro; Shpenzime : 78 810 SEK plus TVSH 19 703 SEK. John Kadelburger, Tarifa : 18 004 euro; Shpenzime : 950 SEK plus TVSH 238 SEK. Kaj Hober, Tarifa : 18 004 euro. Instituti i Arbitrazhit i Dhomës së Tregtisë së Stokholmit Shpenzime administrative : 15 102 euro.

i) Ndërmjet palëve, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë duhet të mbulojë 100 për qind të shpenzimeve ndaj arbitrave dhe Institutit të Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, urdhërohet t'i paguajë J/V Consorzio per il Sistema Informativo CSI-Piemonte dhe FBS SHPK kamatëvonesë mbi shumën në pikën h) më sipër, në normën vjetore prej tre (3) për qind, duke filluar nga data e Vendimit të Arbitrazhit deri në pagesën e plotë.

j) Të gjitha pretendimet e tjera të ngritura në këtë proces arbitrazhi janë refuzuar.

Në përputhje me Seksionin 41 (1) të Ligjit Suedez të Arbitrazhit palët janë informuar se mund të ankimojnë pagesën e shpërblimit të Arbitrave. Ky ankimim duhet të bëhet përpara Gjykatës së Rrethit të Stokholmit (Stokholms tingsratt) brenda tre muajve nga data që palët marrin dijeni për këtë vendim arbitrazhi."

Vendimi i mësipërm rezulton të jetë korrigjuar në datë 27 korrik 2016, me kërkesë të Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive (paditësit), lidhur me paragrafët (b) dhe (i), si më

poshtë :

"[...]

b) Urdhëron Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, t'i paguajë J/V Consorzio per il Sistema Informativo CSI-Piemonte dhe FBS SHPK një shumë prej **718 535** euro me TVSH për pjesën e papaguar të çmimit të Kontratës, bashkë me kamatëvonesën në normën vjetore prej tre (3) për qind (a) mbi 339 104 euro me TVSH, nga data 27 korrik 2014 dhe mbi 83 523 euro me TVSH nga data 1 gusht 2014 deri në datën e Vendimit të Arbitrazhit; (b) mbi 293 908 euro me TVSH, nga data 1 nëntor 2014 deri në datën e vendimit të Arbitrazhit dhe (c) mbi vlerën e përgjithshme prej 716 535 euro nga data e Vendimit të Arbitrazhit deri në pagesën e plotë.

[...]

i) Ndërmjet palëve, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë duhet të mbulojë 100 për qind të shpenzimeve ndaj arbitrave dhe Institutit të Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, urdhërohet t'i paguajë J/V Consorzio per il Sistema Informativo CSI-Piemonte dhe FBS SHPK kamatëvonesë mbi shumën 92 702 euro sipas pikës h) më sipër, në normën vjetore prej tre (3) për qind, duke filluar nga data e Vendimit të Arbitrazhit deri në pagesën e plotë.

[...]"

Me kërkesën objekt gjykimi, Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive ka kërkuar njohjen dhe dhënien fuqi për zbatim në Republikën e Shqipërisë të vendimit të arbitrazhit të shtetit të huaj, atij të Institutit të Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit. Pala kërkuese, duke i'u referuar parashikimit kontraktor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve para këtij arbitrazhi, fakteve që lidhen me lindjen e mosmarrëveshjes dhe atyre procedurale për zgjidhjen e saj, si dhe dispozitave konventore dhe ligjore për njohjen e vendimeve të arbitrazhit të shtetit të huaj, ka parashtruar se nuk ekzistojnë pengesa ligjore për të mos e njohur vendimin e arbitrazhit të shtetit të huaj.

Veç sa më sipër, pala kërkuese ka kërkuar dhe lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin e arbitrazhit të huaj, duke referuar në nenin 511, shkronja "b" të Kodit të Procedurës Civile.

Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Avokatura e Shtetit, kanë kërkuar që vendimi i arbitrazhit të huaj të mos njihet dhe kërkesa të rrëzohet.

Në parashtrimin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme rezulton të jenë renditur një sërë pretendimesh, që lidhen me zbatimin e kontratës së lidhur mesa palëve, të cilat konsistojnë në shkeljet e detyrimeve kontraktore që, sipas ZQRPP, kish kryer pala kërkuese (Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive) dhe që kanë qenë shkaku i zgjidhjes së kontratës. Po ashtu, si nga ZQRPP ashtu edhe nga Avokatura e Shtetit, është parashtruar se në arbitrazh nuk ishin marrë në konsideratë disa nga pretendimet e shtetit shqiptar dhe se ekzistonin pengesat për njohjen e këtij vendimi parashikuar në nenet 5/1(b) dhe 5/2 (b) të Konventës së Nju Jorkut, që lidhen me procesin e rregullt gjyqësor. Konkretisht, është pretenduar se ZRPP i ka kërkuar trupës së arbitrazhit marrjen e një prove shumë të rëndësishme, që ishte këqyrja në terren e Sistemit Informatik të Instaluar dhe Integruar. Kjo kërkesë është refuzuar nga trupa gjykuese, e cila më pas mori një vendim pa verifikuar nëse shërbimet e parashikuara në kontratë ishin kryer apo jo. Në këto kushte pretendohet se, ZRPP ishte në pamundësi për të ushtruar plotësisht dhe në mënyrë shteruese të drejtën e mbrojtjes në respektim të parimit të kontradiktoritetit. Sa më sipër, referuar në nenin 5/2(b) të Konventës së Nju Jorkut, u pretendua se vendimi i arbitrazhit vjen ndesh edhe me parimet

themelore te ligjit të zbatueshëm shqiptar.

Gjykata e apelit, në vlerësim të pretendimeve dhe prapësimeve të palëve pjesëmarrëse në proces, vlerëson se kërkesa për njohjen e vendimit të arbitrazhit të huaj është e drejtë dhe se nuk ka asnjë pengesë për pranimin e saj.

Me ligjin nr. 8688, datë 09.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit", është ratifikuar marrëveshja e mësipërme ndërkombëtare (referuar në vijim si Konventa e Nju Jorkut).

Sipas nenit 1.2 të Konventës termi "vendime arbitrazhi" do të përfshijë jo vetëm vendimet që kanë dhënë arbitrat e emëruar për çdo rast, por gjithashtu edhe ato që kanë dhënë organet e përhershme të arbitrazhit, të cilave u janë nënshtruar palët.

Në bazë të nenit 2, shtetet kontraktore kanë detyrimin që të njohin marrëveshjen e shkruar, sipas së cilës palët marrin përsipër t'ia paraqesin arbitrazhit të gjitha ose ndonjë mosmarrëveshje, që kanë lindur ose mund të lindin ndërmjet tyre lidhur me një marrëdhënie juridike të caktuar, kontraktore ose jokontraktore, që ka lidhje me një çështje, e cila mund të rregullohet me anë arbitrazhi. Në vijim, në pikën 2 të këtij neni jepet kuptimi i termit "marrëveshje e shkruar", sipas të cilit ai do të përfshijë një klauzolë arbitrazhi në një kontratë, ose në një marrëveshje arbitrazhi e nënshkruar nga palët ose që përmbahet në një shkëmbim letrash ose telegramesh.

Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të një arbitrazhi të shtetit të huaj, pala e interesuar duhet të paraqesë së bashku me kërkesën edhe origjinalin e vendimit të vërtetuar rregullisht ose një kopje të vërtetuar në mënyrën e duhur. Ky vendim duhet gjithashtu të jetë i përkthyer nga një përkthyes zyrtar në gjuhën zyrtare të vendit ku kërkohet të njihet vendimi.

Lidhur me kushtet penguese, për shkak të të cilave, vendimi i një arbitrazhi të shtetit të huaj, nuk njihet, në nenin 5 të Konventës së Nju Jorkut, përcaktohet se :

"1. Njohja dhe ekzekutimi i vendimit mund të refuzohet me kërkesën e palës kundër së cilës drejtohet, vetëm në qoftë se ajo palë i paraqet autoritetit kompetent ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi, provën që :

Palët në marrëveshjen që i referohet nenit 2, në bazë të ligjit të zbatueshëm për to, ishin të paafta për të vepruar, ose marrëveshja në fjalë nuk është e vlefshme sipas ligjit, të cilit i janë nënshtruar palët ose mungon ndonjë përcaktim sipas ligjit të vendit ku është dhënë vendimi ose

Palës kundër së cilës jepet vendimi nuk i është dhënë njoftimi i rregullt për caktimin e arbitrit ose të procedurës së arbitrazhit, ose, ka qenë e paaftë për të paraqitur rastin e saj, ose

Vendimi trajton një mosmarrëveshje të paparashikuar në marrëveshjen për arbitrazh ose nuk hyn në klauzolën mbi arbitrazhin ose përmban vendime për çështjet që kalojnë fushën, që i nënshtrohet arbitrazhit; megjithatë në qoftë se vendimet për çështje që i nënshtrohen arbitrazhit mund të veçohen nga ato që nuk i janë nënshtruar, ajo pjesë e vendimit e cila përmban vendime për çështje që i nënshtrohen arbitrazhit, mund të njihet dhe të ekzekutohet; ose

Përbërja e autoritetit të arbitrazhit ose e procedurës së arbitrazhit nuk ishte në përputhje me marrëveshjen e palëve, ose mungon një marrëveshje e tillë, nuk është në përputhje me ligjin e vendit ku është zhvilluar; ose

Vendimi nuk ka marrë formën përfundimtare për palët, ose është anuluar ose pezulluar nga organi kompetent i vendit në të cilin, ose sipas ligjit të të cilit është dhënë vendimi.

2. Njohja dhe ekzekutimi i një vendimi të arbitrazhit mund të refuzohen gjithashtu në qoftë se autoriteti kompetent i vendit ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi konstaton se :

Objekti i mosmarrëveshjes nuk mund të zgjidhet në rrugë arbitrazhi, sipas ligjit të atij vendi, ose

Njohja ose ekzekutimi i vendimit do të vinte në kundërshtim me rendin publik të këtij vendi."

Njohja e vendimeve civile të një arbitrazhi të shtetit të huaj, përveçse me Konventën e Nju Jorkut, nuk rregullohet me ndonjë ligj të posaçëm në Republikën e Shqipërisë. Dispozitat zbatuese në këtë rast gjenden në normat e Kodit të Procedurës Civile. Sipas nenit 399 të këtij Kodi, dispozitat e kreut IX "Njohja e vendimeve të shteteve të huaja", zbatohen edhe për njohjen e një vendimi përfundimtar të arbitrazhit të shtetit të huaj.

Në nenin 394 të këtij Kodi përcaktohen rastet, kur është e ndaluar dhënia fuqi një vendimi civil të shtetit të huaj. Kështu në këtë dispozitë përcaktohet se :

"Vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur :

a. sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës së shtetit që ka dhënë vendimin;

b. kërkesëpadia dhe letërthirrja për në gjyq nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t'i dhënë atij mundësi që të mbrohet;

c. midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare;

ç. është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë;

d. i është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e tij;

dh. nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.„

Si Konventa (neni 5.1) ashtu edhe Kodi i Procedurës Civile (neni 394, shkronja "a"), përcaktojnë si kusht për njohjen e vendimit të arbitrazhit të shtetit të huaj, kompetencën e arbitrave të caktuar apo të organit të përhershëm të arbitrazhit për shqyrtimin e mosmarrëveshjes. Sipas kushteve kontraktore, për të cilat kanë rënë dakord palët, rezulton se ato e kanë përjashtuar juridiksionin gjyqësor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që do të lindnin nga zbatimi i kontratës, duke i'a besuar atë arbitrazhit dhe konkretisht Institutit të Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit. Marrëveshja e lidhur mes palëve për caktimin e kompetencës së arbitrazhit të huaj, nuk është e ndaluar nga ligji shqiptar i cili në të kundërt, lejon njohjen e këtyre vendimeve (zgjidhja e mosmarrëveshjeve kontraktore nuk është në kompetencën ekskluzive të gjykatës). Në rastin në shqyrtim është rënë dakord nga palët që zgjidhja e mosmarrëveshjeve t'i besohet një arbitrazhi të përhershëm siç është ai i Institutit të Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit. Në këtë rast, referuar si vendit ku është marrë vendimi (Suedi) ashtu edhe ligjit procedural që është zbatuar (rregullat që zbaton ky arbitrazh), është e qartë se mosmarrëveshja është zgjidhur nga një arbitrazh i një shteti të huaj (neni 1 i Konventës së Nju Jorkut). Po ashtu, në vijim nuk rezulton që të jetë paraqitur ndonjë pretendim lidhur me përbërjen e autoritetit të arbitrazhit apo të shkeljes së

marrëveshjes mes palëve, lidhur me procedurën e zhvilluar nga arbitrazhi.

Vendimi i arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit, rezulton të jetë përfundimtar dhe i paapelueshëm.

Konventa e Nju Jorkut nëpërmjet dispozitave të saj, inkurajon përdorimin e arbitrazhit dhe lehtëson procedurën e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja të arbitrazhit, duke përcaktuar një numër të kufizuar të shkaqeve, për të cilat mund të refuzohet njohja dhe ekzekutimi (neni 5). Në dallim nga Konventa e Gjenevës e vitit 1927, Konventa e Nju Jorkut vendosi rregullin, sipas të cilit pala e cila kundërshton ekzekutimin e vendimit të huaj të arbitrazhit ka barrën për të provuar se ekziston ndonjë nga shkaqet që pengojnë njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit (neni 5, paragrafi i parë). Kjo zgjidhje tregon një sinjal të qartë të rregullave ndërkombëtare për favorizimin e pozitës procedurale të palës që kërkon njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit.

Ndërkohë sipas paragrafit të dytë të nenit 5 të Konventës së Nju Jorkut, përcaktohen në mënyrë shteruese edhe dy kushte penguese, të cilat verifikohen kryesisht nga gjykata dhe që konsistojnë në ndalimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes nëpërmjet arbitrazhit (çka nuk u konstatua në rastin konkret), si dhe në cenimin e rendit publik si rrjedhojë e njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit.

Nga ZRPP dhe Avokatura e Shtetit u pretendua se ekziston pengesa për njohjen e vendimit të arbitrazhit, duke u mbështetur në rregullin e Konventës së Nju Jorkut që përcakton se : “Palës kundër së cilës jepet vendimi nuk i është dhënë njoftimi i rregullt për caktimin e arbitrit ose të procedurës së arbitrazhit, ose, ka qenë e paaftë për të paraqitur rastin e saj”, duke i’u referuar refuzimit nga arbitrat për marrjen një prove të kërkuar prej tyre gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjes e konkretisht atë të këqyrjes në vend të shërbimeve të kryera nga kërkuesi.

Lidhur me këtë pretendim, gjykata e apelit vlerëson të ndalet në kufijtë e shqyrtimit të çështjes në kuadër të kërkesës për njohjen e vendimit të arbitrazhit të huaj. Sipas nenit 397 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata e apelit nuk e shqyrton çështjen në themel, por vetëm kontrollon nëse vendimi i paraqitur nuk përmban dispozita që vijnë në kundërshtim me nenin 394. Në këtë rast pengesa e përcaktuar në shkronjën “b” të nenit 394 dhe nenin 5.1, paragrafi i tretë të Konventës së Nju Jorkut, kanë një synim të përbashkët që konsiston në garancitë për proces të rregullt gjyqësor për palët e përfshira në një procedurë arbitrazhi. Në këtë aspekt, të dyja dispozitat konsiderojnë si kusht për njohjen e vendimit, njoftimin e palëve për fillimin e procedurës dhe për garantimin e të drejtës për tu dëgjuar dhe mbrojtur. Referuar vendimit të arbitrazhit të huaj që kërkohet të njihet, rezulton se ZRPP dhe Avokatura e Shtetit kanë marrë pjesë në procedurën e arbitrazhit, duke parashtruar pretendimet e tyre (me shkrim dhe me gojë), të cilat kanë gjetur vend dhe janë analizuar edhe në vendimin përfundimtar. Ndër to, rezulton që të jetë kërkuar si provë edhe kryerja e këqyrjes në vend nga ana e arbitrave, të shërbimeve të kryera/pakryera nga paditësi në proces (Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive). Kjo kërkesë për marrjen e provës është refuzuar nga ana e trupës së arbitrave, çka për ZRPP dhe Avokaturën e Shtetit konsiderohet si rrethanë penguese për njohjen e vendimit, pasi pretendohet se në këtë mënyrë, ato nuk kanë mundur të kryejnë një mbrojtje efektive.

Gjykata e apelit evidenton se sipas marrëveshjes së nënshkruar nga palët, shqyrtimi i çështjes nga Instituti i Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit, do të kryhej sipas rregullave të vetë këtij instituti të përhershëm arbitrazhi. Në këto rrethana rezulton se vendimet për drejtimin e procesit dhe zgjidhjen e kërkesave të palëve, qoftë edhe për paraqitjen dhe marrjen e provave, i janë nënshtruar këtyre normave. Ndërkohë pavarësisht rregullave që ekzistojnë apo që vendosen nga palët, lidhur me procedurën e shqyrtimit të

mosmarrëveshjeve, ato nuk mund të vijnë në kundërshtim me atë çka Konventa e Nju Jorkut apo Kodi i Procedurës Civile, parashikojnë në drejtim të garancisë për një proces të rregullt. Ashtu si edhe u përmend më lart, këto rregulla paravendosin kushtin për njoftim të palëve në proces dhe krijimin për to, të mundësisë për tu mbrojtur, apo siç përcakton Konventa e Nju Jorkut, për ta paraqitur rastin. Nuk rezulton që ZRPP dhe Avokatura e Shtetit të mos kenë pasur mundësi të mbrohen para arbitrazhit dhe pretendimi i tyre për këqyrjen në vend, rezulton të jetë refuzuar si një prove jo relevante. Kjo rezulton nga përmbajtja e vendimit (faqja 8 e versionit në shqip) dhe shkaku, për të cilin arbitrazhi e konsideroi të parregullt zgjidhjen e njëanshme të kontratës. Kështu, arsyet për të cilat është zgjidhur kontrata, janë vlerësuar të tilla, që nuk i jepnin të drejtë ZRPP-së që ta bënte një gjë të tillë (faqe 58 e vendimit në versionin shqip). Pavarësisht faktit të pretenduar nga ZRPP se Furnizuesi nuk kishte përmbushur detyrimin e tij kontraktor, për të cilin e zgjidhi kontratën, arbitrazhi ka vlerësuar se zgjidhja e kontratës nuk ishte e ligjshme për arsye se ZRPP duhej ta kish njoftuar Furnizuesin për riparimin e të metës dhe t'i linte atij mundësinë e për ta bërë një gjë të tillë, para se të vendoste zgjidhjen e kontratës.

Zgjedhja me marrëveshje e juridiksionit, nënkupton se palët marrin përsipër të njohin si pushtetin e arbitrave, rregullat procedurale për të cilat kanë rënë dakord dhe, mbi të gjitha, vendimin përfundimtar të arbitrazhit. Në këtë mënyrë, gjykatat e vendit ku kërkohet të njihet vendimi i arbitrazhit, ushtrojnë një kontroll të kufizuar të vendimit, duke përjashtuar kategorikisht drejtësinë e zgjidhjes së çështjes. Në rastin në shqyrtim, nuk rezulton që palët të kenë përcaktuar rregulla të veçanta për lejimin dhe marrjen e provave, duke pranuar në parim t'u nënshtrohen rregullave të paracaktuara të Institutit të Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit. Për rrjedhojë, për sa kohë që ZRPP dhe Avokatura e Shtetit kanë marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes, duke parashtruar të gjitha pretendimet që gjejnë pasqyrim edhe në vendim (përfshirë kërkesën për këqyrje), pretendimi për mosnjohjen e vendimit për arsye të refuzimit për marrjen e një prove, nuk rezulton i bazuar në kushtin pengues të përcaktuar në nenin 5.1 të Konventës së Nju Jorkut.

Fakti i mësipërm procedural, refuzimi për kryerjen e këqyrjes, është pretenduar nga ZRPP dhe Avokatura e Shtetit, se përmbush kushtin pengues të njohjes së vendimit, edhe sipas nenit 5, paragrafi i dytë të Konventës së Nju Jorkut, sepse vjen në kundërshtim me rendin publik (sipas Avokaturës së Shtetit në rastin konkret vendimi i arbitrazhit vjen në kundërshtim me parimet themelore të ligjit të zbatueshëm shqiptar).

Sa i përket përkufizimit të rendit publik nuk ekziston një përkufizim i qartë në legjislacionin shqiptar. Në këto kushte, kjo dispozitë e Konventës së Nju Jorkut do të interpretohet në harmoni edhe me shkronjën "dh" të nenit 394 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit vendimit nuk i jepet fuqi kur ai nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar. Për sa kohë që Konventa e Nju Jorkut i referohet rendit publik të shtetit ku kërkohet të njihet dhe ekzekutohet vendimi i arbitrazhit të huaj, gjykata e apelit vlerëson se vendimi i huaj do të duhet të vijë ndesh me parimet bazë të legjislacionit shqiptar, që të pranohet kërkesa për të mos e njohur atë. Këto parime mishërojnë vlerat e përbashkëta të shoqërisë, mbi të cilat ngrihet dhe funksionon shteti i së drejtës.

Në këtë pikë shtrohet për diskutim çështja nëse vendimi i marrë nga arbitrazhi i huaj në rastin në shqyrtim nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar. Nisur nga formulimi i Konventës së Nju Jorkut mbi këtë kusht pengues, sikurse edhe i shkronjës "dh" të nenit 394 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata e apelit vlerëson se respektimi i rendit publik dhe parimeve të legjislacionit shqiptar, lidhet drejtpërdrejtë me disponimin e vendimit që kërkohet të njihet. Kjo do të thotë se nuk mund të njihet një vendim i arbitrazhit të huaj, i cili në vetvete cenon rendin publik të shtetit ku kërkohet të njihet, apo në rastin në shqyrtim parimet bazë të legjislacionit shqiptar. ZRPP dhe Avokatura e Shtetit nuk parashtruan në kuadër të pretendimit të tyre, se cili apo cilat nga parimet bazë të legjislacionit të shtetit

shqiptar, cenon njohja apo ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit të shtetit të huaj, ndërkohë që i referohen të njëjtit pretendim lidhur me refuzimin e marrjes së një prove. Gjykata e apelit, në të kundërt me sa pretendojnë ZRPP dhe Avokatura e Shtetit, konstaton se zgjidhja e mosmarrëveshjes kontraktore nga Instituti i Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit, nuk vjen ndesh me asnjë parim të legjislacionit shqiptar. Sa i përket pretendimit për refuzimin e marrjes së provës së kërkuar, gjykata e apelit vlerëson se përveç sa u arsyetua më sipër, ky fakt procedural nuk e shpie vendimin përfundimtar në konflikt me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

Lidhur me kërkesën për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin e arbitrazhit të shtetit të huaj, gjykata e apelit vendos të pushojë gjykimin për këtë pjesë të kërkesës.

Në nenin 510, shkronja “c” të Kodit të Procedurës Civile, përcaktohet se vendimet e gjykatave dhe të arbitrazheve të shteteve të huaja, që u është dhënë fuqi sipas dispozitave përkatëse të këtij Kodi, janë tituj ekzekutivë. Si i tillë duhet të konsiderohet edhe vendimi i dhënë nga Instituti i Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit, i datës 06.07.2016 për çështjen nr. V 2015/052, pas njohjes së tij nga gjykata e apelit.

Në vijim në nenin 511, shkronja “b” të Kodit të Procedurës Civile, përcaktohet se titulli ekzekutiv, vendimi i arbitrazhit të shtetit të huaj, që i është dhënë fuqi sipas dispozitave të këtij Kodi, vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, i cili lëshohet nga gjykata brenda 5 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës së kreditorit.

Siç rezulton nga rregullimi i mësipërm, Kodi i Procedurës Civile e ka veçuar procesin e njohjes dhe dhënies fuqi të një vendimi të arbitrazhit të shtetit të huaj, nga ai i vënies në ekzekutim. Vetëm pasi vendimi i arbitrazhit të shteti të huaj është njohur dhe i është dhënë fuqi në Republikën e Shqipërisë, kreditori mund t’i drejtohej gjykatës me kërkesën për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, ndaj për këtë arsye, gjykata e apelit vlerëson se kërkimi për këtë çështje nuk mund të ngrihet në këtë fazë.

Për keto arsye:

PER KETO ARSYE<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

Gjykata e Apelit Tiranë, bazuar në nenet 397, 510, shkronja “c”, 511, shkronja “b” dhe 468 të Kodit të Procedurës Civile

Vendosi:VENDOSI:

Pranimin e kerkeses

Njohjen e vendimit dhe dhenien fuqi per zbatim ne Republiken e Shqiperise te vendimit te InstitutiT te Arbitrazhit te Dhomes se Tregtise se Stokholmit Suedi i dates 06 Korrik 2016 per çeshtjen nr .V2015/052, i korigjuar me vendimin e dates 27 korrik 2016.

Pushimin e gjykimit lidhur me kerkimin per leshimin e urdherit te ekzekutimit.

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.